



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Programi: **Master Shkencor**

Drejtimi: **Histori**

**Lënda: EMIGRACIONI SHQIPTAR/ SHEK.XX, XXI**

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Fatmira Rama
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë 2 leksione 1seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

**Përshkrimi:** Programi synon të pajisë studentët me njohuri e vlera të emigracionit shqiptar përgjatë shek.XX dhe fillimit të shek.XXI. Ai do të ndalet në shkaqet e tij dhe në politikat e shtetit shqiptar përgjatë disa etapave historike. Ai synon të paraqesë dhe veçoritë e emigracionit në këto etapa, vendet ku ata kanë emigruar, kontributin e tyre në ekonominë dhe kulturën shqiptare dhe probleme të integritimit në vendet pritëse.

**Temat e leksioneve:**

- 1.Një tablo e emigracionit shqiptar në vitet 1912-1920. Faktorët ekonomikë dhe politikë të tij dhe ngulimet më të spikatura të diasporës shqiptare. Kontributi i shoqërive dhe organizatave kombëtare për njohjen e shtetit shqiptar, kundër copëtimit të Shqipërisë dhe ringritjen e pas Luftës I Botërore.
2. Zhvillimet kulturore të shqiptarëve në emigracion dhe rrezatimi i tyre në shtetin shqiptar, 1912-1920.
3. Emigracioni shqiptar në vitet 1920-1939. Shkaqet ekonomike dhe politike të emigracionit shqiptar. Politikat shtetërore shqiptare të emigracionit dhe politikat zyrtare ndaj emigrantëve në shtetet pritëse.
4. Ndikimi i emigracionit shqiptar në rrjedhat ekonomike, politike dhe kulturore në Shqipëri në vitet 20-30 tëshek.XX. Bashkëpunimi me shtetin shqiptar dhe me shoqëritë vendase në këto fusha.
5. Emigracioni masiv i detyruar i shqiptarëve në Kosovë dhe në viset e tjera në Jugosllavi dhe Greqi në gjysmën e parë të shek.XX. Vështirësitë gjatë udhëtimit dhe në vendet pritëse në aspektin e integritimit ekonomiko-social.
6. Veprimtaria kulturore e diasporës shqiptare në Rumani, Bullgari, Turqi, Francë, Itali, SHBA, Argjentinë, Egjipt etj.
7. Pushtimi i Shqipërisë dhe qëndrimi i diasporës shqiptare. Veprimtaria antifashiste e saj, në Europë, në Turqi, në Angli, SHBA, në vendet arabe dhe në vendet e Amerikës Latine përgjatë Luftës së Dytë Botërore.
8. Aspekte të veprimtarisë së diasporës së vjetër shqiptare në Itali. Organizimi shoqëror i tyre dhe bashkëpunimi me vendin amë, 1912-1939.
9. Emigracioni politik shqiptar në vitet e Republikës dhe të Monarkisë shqiptare dhe në fund tëLuftës II Botërore. Organizatat politike në emigracion dhe bashkëpunimi me mërgatën ekonomike shqiptare.

10. Politikat shtetërore të pas Luftës II Botërore në Shqipëri ndaj emigracionit dhe diasporës shqiptare (1945-1990).
11. Organizatat dhe shoqëritë kulturore, kombëtare dhe politike në diasporën shqiptare dhe qëndrimi i tyre ndaj regjimit komunist në Shqipëri (1945-1990).
12. Eksodi masiv shqiptar në prag të rrëzimit të regjimit komunist dhe gjatë tranzicionit shqiptar dhe shkaqet e tij ekonomike, politike dhe shoqërore (1990-2010).
13. Një tablo e emigracionit shqiptar në vitet 1990-2010 dhe shkalla e organizimit të tij. Roli i tij në ekonominë shqiptare.
14. Integrimi i emigrantëve shqiptarë në shoqëritë vendase, aktiviteti i tyre ekonomik e kulturor dhe raportet me vendin amë. Figura të shquara të diasporës së sotme shqiptare.
15. Diaspora e vjetër në Itali e Greqi në vitet 1945-2010 dhe raportet e tyre me Shqipërinë.

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

1. *Historia e popullit shqiptar*, Vëll. III, IV, Tiranë: Toena, 2008, 2009.
2. *Emigrimi i elites intelektuale nga Shqipëria*, grup autorësh, Tiranë: Toena 1999

#### **Literatura plotësuese:**

- Aristidh Kola, *Arvanitasit*, Tiranë, 2002
- Gelcu Maksutoviç, *Despre Albania di Albanezi*, Bukuresti, 1995
- Mark Tirtja, *Migrime të shqiptarëve*, në "Etnografia shqiptare", nr. 18, Tiranë, 1998
- *Shqiptarët e Italisë*, Përmbledhje studimesh, grup autorësh, Tiranë, Eugen, 1997
- *Emigrimi i elites intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit*, grup autorësh, Tiranë, 1999
- Revista "Përpyekja", nr. 26-27, Tiranë, 2010, Mërgimi shqiptar pas vitit 1990.
- Sadik Bata, *Historia e shqiptarëve të Argjentinës gjatë viteve 1901-1968*, Buenos Aires, 1971.
- Nasho Jorgaqi, *Jeta e F. S. Nolit*, vëll. 1, 2, Tiranë, 2005
- Beqir Meta, *Federata Panshqiptare "Vatra"*, Globus, 2006

**MIRATOI**

**Tiranë, 2016**

**Përgjegjësi i Departamentit  
Prof. asoc. Eva Hyskaj**